

Ideathon “STEM & AI për komunitetin”

Më 27 mars 2026, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës organizoi Ideathon-in “STEM & AI për komunitetin”, një aktivitet njëditor që bashkoi studentë të universitetit dhe nxënës të shkollave të mesme për të zhvilluar ide dhe zgjidhje inovative për probleme konkrete të komunitetit.

Ideathon-i kishte si qëllim nxitjen e kreativitetit, mendimit kritik, punës në ekip dhe përdorimit të përgjegjshëm të teknologjisë dhe inteligjencës artificiale. Pjesëmarrësit u angazhuan në identifikimin e problemeve reale dhe në konceptimin e zgjidhjeve të realizueshme me ndikim social, ekonomik, arsimor dhe mjedisor.

Pas procesit të aplikimit dhe përzgjedhjes, në aktivitet morën pjesë 15 studentë dhe gjimnazistë, të organizuar në pesë ekipe me nga tre anëtarë. Çdo ekip përbëhej nga studentë dhe nxënës gjimnazi, ndërsa ndarja u realizua duke u bazuar në ngjashmërinë e ideve të paraqitura në aplikim.

Ekipet punuan në pesë drejtime tematike:

- Smart Education, me fokus në edukimin inteligjent dhe orientimin akademik e profesional;
- Youth Development, me fokus në zhvillimin e të rinjve dhe krijimin e hapësirave rekreative e kreative;
- Smart Community, me fokus në informimin qytetar, turizmin dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje;
- Green City, me fokus në menaxhimin e mbetjeve, ndotjen dhe reduktimin e emetimeve të CO₂;
- Smart Economy, me fokus në transportin publik, planifikimin inteligjent të udhëtimeve dhe promovimin e bizneseve lokale.

Gjatë aktivitetit, ekipet zhvilluan idetë e tyre, përcaktuan problemin dhe grupin e synuar, konceptuan rolin e inteligjencës artificiale dhe përgatitën skica, diagrame, prototipe vizuale ose prezantime të zgjidhjeve të propozuara. Në përfundim, secili ekip prezantoi punën e tij përpara jurisë.

Projektet u vlerësuan mbi bazën e rrisë dhe inovacionit, zbatueshmërisë praktike, përdorimit të teknologjisë dhe inteligjencës artificiale, ndikimit në komunitet, cilësisë së prezantimit dhe bashkëpunimit në ekip.

Juria e Ideathon-it

Juria përbëhej nga profesionistë me përvojë në teknologji, sipërmarrje, startup, edukim dhe zhvillimin e të rinjve:

- Alban Isteri, CEO i SITS dhe Work Safety, drejtues ekzekutiv dhe sipërmarrës me përvojë në sektorin publik dhe privat, zhvillimin e biznesit, teknologjinë, sigurinë dhe transformimin digjital;
- Hatixhe Bilibashi, eksperte me përvojë të gjatë në TIK, zhvillim softueri, inovacion, menaxhim projektesh dhe mentorim startup-esh, themeluese e Make with ICT, Albanian ICT Academy dhe STEM Hub;

- Jusilda Vreka, mësuese e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, me fokus në inovacionin në arsim, mentorimin, projektet STEAM, robotikën dhe fuqizimin e të rinjve përmes teknologjisë.

Kontributi i jurisë, pyetjet dhe sugjerimet e dhëna pas prezantimeve u ofruan pjesëmarrësve një perspektivë profesionale dhe konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të ideve të tyre.

Bashkëpunëtorët dhe sponsorët

Ideathon-i u realizua në bashkëpunim me SITS, Security Information Technology Service Solutions, e cila ishte edhe sponsori kryesor i aktivitetit. SITS është një kompani shqiptare e specializuar në teknologjinë e informacionit, sigurinë kibernetike, menaxhimin e infrastrukturave digjitale, cloud, inteligjencën artificiale dhe automatizimin e proceseve.

Mbështetja e SITS kontribuoi drejtpërdrejt në realizimin e aktivitetit dhe në motivimin e të rinjve për të zhvilluar ide që lidhin teknologjinë me nevojat reale të komunitetit.

Një falenderim i veçantë i drejtohet gjithashtu Gjika Event, për mbështetjen si sponsor i aktivitetit.

Shkollat pjesëmarrëse

Në Ideathon morën pjesë nxënës nga:

Gjimnazi “Sami Frashëri”, Tiranë;

Turgut Ozal, Durrës;

Gjimnazi “Rilindja”, Durrës.

Pjesëmarrja e nxënësve të shkollave të mesme dhe bashkëpunimi i tyre me studentët krijuan një mjedis të hapur për shkëmbimin e ideve, mentorimin ndërmjet bashkëmoshatarëve dhe zhvillimin e aftësive të punës në grup.

Rezultatet e aktivitetit

Në përfundim të Ideathon-it, ekipet u vlerësuan me çmime motivuese sipas profilit dhe kontributit të secilës ide:

- “Inovacion në Edukim”;
- “Ndikimi te të Rinjtë”;
- “Qyteti Inteligjent”;
- “Zgjidhje për Mjedisin”;
- “Ideja më Praktike”.

Grupi Smart Education u shpall fitues i Ideathon-it dhe fitoi të drejtën për të vijuar automatikisht në aktivitetin Startup 2026, të zhvilluar më 3 prill 2026.

Ideathon-i “STEM & AI për komunitetin” përforcoi rëndësinë e krijimit të hapësirave ku universiteti, shkollat e mesme, biznesi dhe profesionistët e fushës bashkëpunojnë për të nxitur inovacionin dhe angazhimin e të rinjve në zgjidhjen e sfidave të komunitetit.

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit falenderon të gjithë studentët, nxënësit, mësuesit, anëtarët e jurisë, partnerët, sponsorët dhe grupin organizator për kontributin në realizimin me sukses të aktivitetit.

Edicioni i katërt i Konferencës Shkencore Studentore “Matematika dhe Mësimdhënia”

Më 17 prill 2026, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, u zhvillua edicioni i katërt i Konferencës Shkencore Studentore “Matematika dhe Mësimdhënia”. Kjo nismë, e organizuar nga Departamenti i Matematikës pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, është kthyer tashmë në një traditë të rëndësishme akademike në universitet.

Konferenca u përshëndet nga Rektori i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi, i cili theksoi rëndësinë e matematikës si një nga themelet e mendimit logjik dhe kritik, si dhe rolin e studentëve në ndërtimin e së ardhmes përmes kërkimit shkencor dhe inovacionit.

Në një periudhë transformimesh të shpejta, kur inteligjenca artificiale dhe teknologjitë digjitale po ndryshojnë mënyrën se si mësojmë dhe japim mësim, konferenca solli në vëmendje rëndësinë e ndërthurjes së matematikës, teknologjisë dhe metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Aktiviteti evidentoi gjithashtu potencialin e studentëve dhe rëndësinë e përfshirjes së tyre në veprimtaritë kërkimore dhe akademike.

Organizimi i edicionit të katërt dëshmon vazhdimësinë e kësaj konference dhe angazhimin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Departamentit të Matematikës për nxitjen e kërkimit shkencor studentor, shkëmbimin e ideve dhe zhvillimin e kulturës akademike në universitet.

Startup Studentor 2026

Më datë 3 prill 2026, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, organizoi aktivitetin “Startup Studentor 2026 – Konkurs për Ide Startup-esh nga Studentët”, në Sallën e Konferencave të godinës së Universitetit në Currila.

Aktiviteti u organizua me synimin për të nxitur kulturën e inovacionit dhe sipërmarrjes në radhët e studentëve, për të zhvilluar aftësitë e tyre në ndërtimin dhe prezantimin e ideve të biznesit, si dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet universitetit dhe industrisë.

Në konkurs morën pjesë studentë të programeve Bachelor dhe Master, individualisht ose të organizuar në ekipe. Studentët prezantuan 17 ide startup-esh, të orientuara drejt problematikave dhe nevojave konkrete të shoqërisë, biznesit dhe komunitetit.

Idetë e paraqitura mbuluan fusha të ndryshme, ndër të cilat:

- Inteligjenca Artificiale;
- siguria kibernetike;
- edukimi dhe teknologjitë arsimore;
- shëndetësia digjitale;
- bujqësia inteligjente;
- turizmi dhe promovimi i destinacioneve;
- blockchain;
- shërbimet universitare;
- punësimi dhe zhvillimi i karrierës;
- menaxhimi dhe automatizimi i proceseve të biznesit.

Formati i konkursit

Përpara aktivitetit, pjesëmarrësit përgatitën dhe dorëzuan një Concept Note, në të cilën paraqitën problemin e identifikuar, zgjidhjen e propozuar, përdoruesit ose klientët e synuar, vlerën unike të idesë, modelin e biznesit dhe mundësitë për zbatimin e saj.

Gjatë aktivitetit, secili startup realizoi një prezantim të strukturuar, në formatin pitch, përpara jurisë dhe të pranishmëve. Prezantimet u përqendruan te:

- problemi që synohej të zgjidhej;
- zgjidhja e propozuar;
- produkti ose teknologjia;
- tregu dhe përdoruesit e synuar;
- modeli i biznesit;
- konkurrenca dhe avantazhi i idesë;
- kapaciteti i ekipit për ta zhvilluar startup-in.

Pas çdo prezantimi u zhvillua një sesion pyetjesh dhe përgjigjesh, gjatë të cilit anëtarët e jurisë kërkuar sqarime dhe ofruan komente profesionale për zhvillimin e mëtejshëm të ideve.

Juria profesionale

Startup-et u vlerësuan nga një juri e përbërë nga profesionistë me përvojë në teknologjinë e informacionit, inteligjencën artificiale, sigurinë kibernetike, rrjetet kompjuterike, menaxhimin dhe zhvillimin e biznesit:

- Alvi Kaja, profesionist në teknologjinë e informacionit dhe sigurinë kibernetike, aktualisht Drejtor Teknik dhe Marketing në SITS;
- Aurora Kapo, Menaxher i Strategjisë së Inteligjencës Artificiale në HSBC UK;
- Erion Demiri, ekspert në teknologjinë e informacionit dhe rrjetet kompjuterike, themelues i Etronic.al dhe trajner i certifikuar në teknologjitë MikroTik dhe Ubiquiti.

Juria vlerësoi startup-et duke u bazuar në qartësinë dhe rëndësinë e problemit, inovacionin, zbatueshmërinë, potencialin e tregut, modelin e biznesit, përdorimin e teknologjisë, përgatitjen e ekipit dhe cilësinë e prezantimit.

Bashkëpunëtorët dhe sponsorët

Aktiviteti u zhvillua në bashkëpunim me SITS – Security Information Technology Service Solutions, kompani e specializuar në teknologji, siguri kibernetike dhe transformim digjital, e cila ishte edhe sponsori kryesor i aktivitetit.

Një falenderim i veçantë i drejtohet Etronic.al për mbështetjen kryesore dhe për ofrimin e dy trajnimeve profesionale, si mundësi konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të studentëve.

Mbështetës të tjerë të aktivitetit ishin edhe Gjika Event.

Mbështetja e sponsorëve kontribuoi në realizimin e aktivitetit, në ofrimin e çmimeve dhe mundësive të zhvillimit profesional për studentët, si dhe në forcimin e lidhjes ndërmjet Fakultetit dhe sektorit privat.

Çmimet dhe vlerësimet

Në përfundim të konkursit, bazuar në vlerësimin e jurisë, u shpallën fituesit e tre çmimeve kryesore:

Vendi i Parë: AgroSmart Albania

Vendi i Dytë: Durrës Guide

Vendi i Tretë: EduKAD

Përveç tre çmimeve kryesore, startup-et pjesëmarrëse u vlerësuan edhe me certifikata dhe çmime motivuese, të përshtatura sipas veçantisë, fushës dhe potencialit të secilës ide.

Një hapësirë për zhvillimin e ideve studentore

“Startup Studentor 2026” krijoi një hapësirë ku studentët patën mundësi të shndërronin njohuritë akademike në zgjidhje konkrete, të përballëshin me pyetje profesionale dhe të merrnin rekomandime të drejtpërdrejta nga ekspertë të industrisë.

Aktiviteti dëshmoi potencialin krijues dhe sipërmarrës të studentëve të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe rëndësinë e organizimit të nismave që lidhin arsimin universitar me inovacionin, teknologjinë dhe nevojat reale të tregut.

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit do të vijojë të mbështesë nisma të tilla, me synimin për të krijuar më shumë mundësi për zhvillimin profesional të studentëve, bashkëpunimin me industrinë dhe transformimin e ideve të tyre në zgjidhje me ndikim të qëndrueshëm.

International Conference on Complex System Modelling and Artificial Intelligence – CSMAI 2026.

Konferenca Ndërkombëtare CSMAI 2026 mbi Modelimin e Sistemeve Komplekse dhe Inteligjencën Artificiale

Në datat 21–22 maj 2026, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës organizoi International Conference on Complex System Modelling and Artificial Intelligence – CSMAI 2026.

Konferenca u zhvillua në format hibrid, me pjesëmarrje fizike dhe online. Dita e parë u organizua në Adriatik Hotel, Durrës, ndërsa dita e dytë, përfshirë sesionet paralele të prezantimit të punimeve shkencore, u zhvillua në godinën qendrore të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.

CSMAI 2026 shërbeu si një platformë ndërkombëtare për diskutime ndërdisiplinore, prezantimin e rezultateve kërkimore dhe shkëmbimin e njohurive në fushat e Sistemeve Komplekse, Inteligjencës Artificiale, Machine Learning, Data Engineering, Data Science, Cybersecurity, Software Engineering, teknologjive arsimore, aplikimeve në shëndetësi, transformimit digjital dhe qëndrueshmërisë. Konferenca synoi të afronte zhvillimet teorike me zbatimet praktike dhe të nxiste bashkëpunimin ndërmjet studiuesve, akademikëve, profesionistëve të industrisë dhe institucioneve shkencore.

Interesi i komunitetit kërkimor për konferencën ishte i konsiderueshëm. Në total u dorëzuan 457 punime shkencore nga autorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Pas procesit të vlerësimit, 39 punime u pranuan për prezantim, duke rezultuar në një normë pranimi prej afërsisht 8.53%.

Ky rezultat dëshmon natyrën përzgjedhëse të konferencës dhe vëmendjen e kushtuar cilësisë, origjinalitetit dhe rëndësisë shkencore të punimeve.

Ceremonia e hapjes përfshiu fjalën e Rektorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, fjalën e mirëseardhjes nga drejtuesit e konferencës dhe kontributet e të ftuarve ndërkombëtarë. Në program morën pjesë Aninda Bose, Executive Editor në Springer, si dhe të ftuarit S. Bhattacharyya dhe D. Samanta.

Programi akademik u pasurua me sesione plenare dhe tutoriale mbi tema bashkëkohore. Aninda Bose zhvilloi sesionin “Elements of Scientific Publishing”, S. Bhattacharyya prezantoi “Introduction of Quantum Computing”, S. Podder trajtoi temën “AI-Powered Skill Development for Future Green Jobs”, ndërsa I. Pan zhvilloi online sesionin “Emotional Intelligence for Rational and Ethical Design”.

Në datën 22 maj, prezantimet e punimeve u organizuan në katër sesione paralele. Sesionet u drejtuan nga Session Chairs dhe u mbështetën nga grupet Technical In-Charge, të cilat siguruan koordinimin e prezantimeve fizike dhe online, menaxhimin teknik dhe respektimin e programit.

Punimet e prezantuara trajtuan aplikime të inteligjencës artificiale në shëndetësi, arsim, financë, siguri kibernetike, qytete inteligjente, inxhinieri softuerike, përpunim të gjuhës natyrore, computer vision, deep learning, federated learning dhe teknologji të orientuara drejt qëndrueshmërisë. Format i hibrid mundësoi pjesëmarrjen e autorëve nga vende dhe institucione të ndryshme.

Punimet e përzgjedhura u morën në konsideratë për publikim në proceedings të Springer, në serinë Lecture Notes in Networks and Systems, duke u ofruar autorëve një kanal të njohur ndërkombëtar për shpërndarjen dhe rritjen e dukshmërisë së rezultateve kërkimore.

Në kuadër të konferencës u vlerësuan edhe kontributet kërkimore më të spikatura përmes kategorive Best Paper Award dhe Social Impact Award. Programi përmbyllës përfshiu ndarjen e çmimeve, vlerësimin e vullnetarëve dhe bashkëpunëtorëve, një aktivitet kulturor kushtuar kulturës shqiptare dhe fjalën e falënderimit.

Organizimi i CSMAI 2026 përfaqësoi një arritje të rëndësishme për Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës. Konferenca kontriboi në rritjen e dukshmërisë institucionale, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe krijimin e mundësive të reja për kërkim shkencor, publikime, shkëmbime akademike dhe nisma të përbashkëta në fushën e teknologjisë dhe inteligjencës artificiale.